



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Në çështjen juridike të :

AC-I-22-0507-A0001

N L, Prizren.

Paditësi/Ankuesi

Kundër:

E paditura

N.SH “ELAN” (në likuidim), e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. ”Dritan Hoxha”, nr.55, Lakrishte, Prishtinë

Kolegji i Apelit i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), i përbërë nga Mr.sc. Sahit Sylejmani, gjyqtar kryesues, Ilmi Bajrami dhe Agron Hoxhaj, gjyqtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të paraqitur kundër Aktgjykimit të shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-1619, të datës 17 gusht 2022, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 11 janar 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

1. Ankesa e paditësit refuzohet si e pabazuar.
2. Vërtetohet Aktgjykimi i shkallës së parë të DHPGJS-së, C-IV-14-1619, i datës 17 gusht 2022.
3. Nuk caktohen taksa gjyqësore për procedurën ankimore.

Rrethanat procedurale dhe faktike

Me datë 6 mars 2014, ankuesi kishte parashtruar një kërkesë për rishikim kundër Vendimit të Autoritetit të Likuidimit me nr. PRZ015-0128 të datës 14 shkurt 2014, me të cilin vendim kërkesa e paditësit për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës në shumë prej 800.00 euro ishte refuzuar si e pabazuar. Kjo për faktin se fillimisht kërkesa e paditësit ishte paraqitur me datë 31 dhjetor 2010 që është pas afatit për parashtrimin e kërkesave (31 maj 2008. Tutje lista e pagave të fundit para datës së nënshkrimit të kontratës së privatizimit (20 korrik 2007) e paraqitur nga menaxhmenti i N.SH-së nuk pasqyron ndonjë pagesë të kryer ndaj parashtruesit të kërkesës. AL kishte vërejtur se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së kur e njëjta u privatizuar dhe se i njëjti nuk është pushuar nga puna si pasojë e një veprimi të ndërmarrë nga Agjencia.

Në kërkesë theksohet se paditësin askush nuk e ka lajmëruar se i njëjti është pushuar nga marrëdhënia e punës, se i njëjti është paraqitur herë pas here në punë mirëpo nuk ka pasur punë. I njëjti thekson se marrëdhënia e punës i është shkëputur pa dëshirën e tij dhe se N.SH për çfarëdo rasti është dashur ta njoftoj me shkrim apo ndonjë mënyrë tjetër dhe për këtë paditësi konsideron se nuk është fajtor. I njëjti mendon se i takon dëmshpërblimi sikur gjithë punëtorëve tjerë dhe se AKP nuk e ka vërtetuar gjendjen faktike në mënyrë reale. Kërkesës i kishte bashkëngjitur vendimin e lartcekur të Autoritetit të Likuidimit, kopjen e letërnjoftimit dhe kopjen e kartelës bankare.

Me datë 21 tetor 2021, AKP-ja kishte paraqitur mbrojtjen e saj në të cilën thekson se listat e pagave të fundit para datës së nënshkrimit të kontratës së privatizimit e paraqitur nga menaxhmenti i N.SH-së nuk pasqyron ndonjë pagesë të kryer ndaj parashtruesit të kërkesës. AL vëren se parashtruesi i kërkesës nuk ka qenë punëtor aktiv i N.SH-së kur u privatizua N.SH-ja dhe i njëjti nuk është pushuar nga puna si pasojë e ndonjë veprimi të ndërmarrë nga AKP siç parashihet me nenin 6.1. apo 6.2. të Ligjit për AKP-në. Andaj, AL konstaton se parashtruesit të kërkesës nuk i takon e drejta për përfitim nga dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës dhe i propozon gjykatës të refuzoj ankesën si të papranueshme dhe të pabazuar, ndërsa të vërtetoj vendimin e Autoritetit të Likuidimit.

Me datë 17 gusht 2022, shkalla e parë e DHPGJS-së me Aktgjykimin C-IV-14-1619 e kishte refuzuar si të pabazuar ankesën e paditësit, ndërsa kishte vërtetuar vendimin e ankimuar të Autoritetit të Likuidimit. Në arsyetimin e këtij Aktgjykimi theksohet se ankuesi nuk e kishte dorëzuar kërkesën në AL të AKP-së brenda afatit ligjor të shpallur nga ana e AKP-së për parashtrimin e kërkesave kreditore. N.SH “Elan” kishte hyre në likuidim dhe AKP-ja kishte publikuar njoftimin për fillimin e likuidimit të N.SH-së ku edhe kishte njoftuar të gjithë kreditorët potencial të N.SH “Elan” (në likuidim) se afati për parashtrimin e kërkesave është deri më datën 31 maj 2008. Publikimet ishin bërë në shtypin ditor dhe në uebin e AKP-së. Nga shkresat del se ankuesi kërkesën e tij e kishte parashtruar me 31 dhjetor 2010. Andaj nga kjo konstatohet se ankuesi kërkesën e tij e ka parashtruar pasi që ka kaluar afati i parashtrimit të kërkesave sipas informimit të bërë nga AKP-ja. Ankuesi në ankesë nuk kishte sjellë asnjë pretendim apo dëshmi të besueshme që do ta justifikonte vonesën e tij në parashtrimin e kërkesës te Autoriteti i Likuidimit dhe nuk është ndalur fare në arsyetimin e vonesës. Nga data e fundit për parashtrimin e kërkesave 31 maj 2008 deri në datën e parashtrimit të kërkesës së tij me 31 dhjetor 2010 në Autoritetin e Likuidimit, ankuesi ka rënë rreth 2 vite e gjysmë në vonesë të pajustificuar. Andaj kërkesa e dorëzuar tek AL me një vonesë të tillë me të drejtë është refuzuar si e pavlefshme.

Me datë 8 shtator 2022, paditësi (ankuesi) kishte paraqitur një ankesë kundër Aktgjykimit C-IV-14-1619 të datës 17 gusht 2022 (aktgjykimin e ankimuar), për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së të drejtës materiale duke i propozuar Kolegjit të Apelit të DHPGJS-së që ankesën e paditësit ta aprovoj, ndërsa aktgjykimin e ankimuar ta anuloj si dhe kërkesën për pagesën e kompensimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës ta aprovoj në tërësi si të bazuar. Në ankesë theksohet se gjykata nuk ka vërtetuar gjendjen faktike pasi që paditësi ka qenë në marrëdhënie pune të N.SH nga viti 1982 deri më 23 korrik 2007 kur ishte privatizuar N.SH-ja. Tutje, thekson se shkalla e parë e DHPGJS-së nuk e ka shqyrtuar kërkesën e paditësit me arsyetimin se kërkesa e të njëjtit është e paafatshme dhe arsyeja që paditësi e ka parashtruar pas afatit kërkesën thekson se është se i njëjti ka qenë i sëmurë dhe nuk ka qenë në gjendje të përcjellë shpallje publike në gazetë.

Me datë 26 shtator 2023, AKP-ja kishte paraqitur përgjigje në ankesën e paditësit në të cilën thekson se argumentet e paraqitura në ankesë janë të përsëritura dhe i propozon Kolegjit të

Apelit të DHPGJS-së që të refuzoj ankesën si të pabazuar, ndërsa të vërtetoj Aktgjykimin e ankimuar.

Arsyetimi ligjor:

Ankesa e paditësit refuzohet si pabazuar.

Në bazë të nenit 69.1 të Ligjit nr. 06/L-086 mbi Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (LDHP), Kolegji i Apelit vendosi të mos mbajë pjesën gojore të procedurës.

Merita e ankesës dhe vlerësimi i Kolegjit të Apelit

Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së është i drejtë në rezultat dhe në arsyetimin e tij dhe si i tillë i njëjti duhet të vërtetohet.

Kolegji i Apelit vëren se paditësi e kishte paraqitur kërkesën e tij para Autoritetit të Likuidimit me datë **31 dhjetor 2010**, që sipas vlerësimit të Autoritetit të Likuidimit është e paraqitur pas afatit për parashtrimin e kërkesave që ishte **me 31 maj 2008**. Përveç kësaj kishte konstatuar se nga listat e pagave të fundit të N.SH-së paditësi nuk rezulton të ketë qenë punëtor aktiv i N.SH-së apo se të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës si rezultat i ndonjë veprimi të AKP-së.

Paditësi me rastin e paraqitjes së ankesës së tij nuk e kishte kontestuar faktin se kërkesën e kishte paraqitur pas afatit për parashtrimin e kërkesave dhe si prova kishte bashkëngjitur vetëm vendimin e ankimuar të AL-së, kopjen e letërnjoftimit dhe atë të xhirollogarisë bankare.

Gjithashtu, Kolegji i Apelit vëren se shkalla e parë e DHPGJS-së pas vlerësimit të provave dhe shkresave të lëndës kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar mbi arsyet se e njëjta ishte parashtruar pas afatit për parashtrimin e kërkesave dhe se i njëjti nuk kishte paraqitur asnjë provë në mënyrë që të justifikonte vonesën e tij në parashtrimin e kërkesës.

Paditësi në ankesën e tij të paraqitur pranë Kolegjit të Apelit, vonesën e tij lidhur me paraqitjen e kërkesës para AL-së e arsyeton me faktin se ka qenë i sëmurë dhe nuk ka pasur mundësi të përcjellë shpalljet publike duke mos i argumentuar pretendimet e tij me prova.

Kolegji i Apelit vlerëson se shkalla e parë kishte vendosur drejtë kur kishte refuzuar ankesën e paditësit si të pabazuar.

Kjo për faktin se paditësi përveç që ashtu siç me të drejtë e thekson shkalla e parë, e kishte paraqitur kërkesën e tij pranë AL-së me vonesë përkatësisht me datë 31 dhjetor 2010, që është pas afatit për parashtrimin e kërkesave dhe atë me 31 maj 2008, i njëjti nuk paraqet asnjë provë as në shkallë të parë të DHPGJS-së ashtu edhe para Kolegjit të Apelit me qëllim që të vërtetoj ndonjë pretendim të shkruar me anë të ankesave të paraqitura të tij.

Përndryshe, paditësi e pranon në ankesën e tij të paraqitur para Kolegjit të Apelit që kërkesën e ka paraqitur pas afatit për arsye se ka qenë i sëmurë, mirëpo nuk e bashkëngjet asnjë provë të vetme në mënyrë të t'i mbështesë pretendimet e tij të shkruara në prova apo dëshmi.

Prandaj, në mungesë të provave, Kolegji i Apelit vlerëson se ankesa e paditësit duhet të refuzohet si e pabazuar dhe të vërtetohet Aktgjykimi i ankimuar i shkallës së parë të DHPGJS-së.

Andaj, nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Taksa gjyqësore

Sipas nenit 13.9 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2017 (UA) të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), ankesat e punëtorëve lidhur me pagat e pa paguara për shumën deri në 1,000.00 euro lirohen nga pagesa e taksës gjyqësore.

U vendos nga Kolegji i Apelit i DHPGJS-së më 11 janar 2024.

Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar Kryesues
